<p>sigurinë e njerëzve dhe/ose të pronës brenda hapësirës së siguruar, të ndërpresin menjëherë veprimet e tyre;</p> <p>1.3. Identifikon personat dhe automjetet gjatë hyrjes dhe daljes nga rajoni i siguruar nëse është e domosdoshme për njerëzit dhe/ose pronën.</p> <p>2. Me pëlqimin e personit, punëtori i sigurimit mund të kontrolljë gjësendet dhe automjetet gjatë hyrjes dhe daljes nga hapësira e siguruar.</p> <p>3. Me pëlqimin e personit, punëtori i sigurimit mund të kryejë kontrollimin me prekje:</p> <p>3.1.Kontrollimet me prekje duhet të kryhen nga punëtori i sigurimit i gjinisë së njëjtë me personin që kontrollohet;</p> <p>3.2. Nëse personi refuzon pëlqimin për kontrollimin me prekje gjatë tentimit për të hyrë në hapësirën e siguruar, punëtori i sigurimit mund të refuzojë hyrjen e personit;</p> <p>3.3.Nëse personi refuzon pëlqimin për kontrollimin me prekje gjatë tentimit për të dalur nga hapësira e siguruar, punëtori i sigurimit ndalon personin dhe menjëherë njoftojnë Policinë e Kosovës.</p>	<p>security of people and/or property within the Secure Area to cease their actions immediately;</p> <p>1.3. Identify subjects and vehicles during entry to, and exit from a Secured Area, if it is necessary for the security of people and/or property.</p> <p>2. With a subject's consent, a Security Worker may check the possessions and vehicles upon entry to and exit from a Secure Area.</p> <p>3. With a subject's consent, a Security Worker may conduct a Pat-down search:</p> <p>3.1.Pat-down searches must be performed by a Security Worker of the same gender as the person being searched.</p> <p>3.2.If a person refuses consent for a Pat-down search while attempting to enter a secure area, the Security Worker may deny the subject entry.</p> <p>3.3.If a person refuses consent for a Pat-down search while attempting to exit a Secure Area, the Security Worker may hold the person and must call the Kosovo Police immediately.</p>	<p>bezbednost ljudi i/ili imovine unutar reona obezbeđenja, da odmah prestanu sa tim radnjama;</p> <p>1.3 Identifikuje lica i vozila prilikom ulaska i izlaska iz reona obezbeđenja ako je nophodno za ljude i/ili imovinu.</p> <p>2. Uz saglasnost lica, radnik obezbeđenja može da kontroliše sredstva i vozila prilikom ulaska i ilaska iz reona obezbeđenja.</p> <p>3. Uz saglasnost lica, radnik obezbeđenja može da vrši kontrolu dodirom:</p> <p>3.1.Kontrole dodirom treba da se izvrše od radnika obezbeđenja istog pola kao i lica koje se kontroliše;</p> <p>3.2. Ako lica odbije kontrolu dodirom prilikom nadstojanja da ulazi u reon obezbeđenja, radnik obezbeđenja može da odbije ulaz lica;</p> <p>3.3. Ako lice odbije saglasnost o kontrolu dodirom prilikom nastojanja za izlaz iz reona obezbeđenja, radnik obezbeđenja zaostavlja lica treba odmah informise Kosovsku Policiju.</p>
---	---	---

<p>4.Punëtori i sigurimit mund të mbajë personin vetëm nëse dyshon se personi ka kryer, ose është në proces të kryerjes ose do të kryejë një vepër penale.</p> <p>5.Nëse punëtori i sigurimit e ndalon personin apo automjetin të dalë nga hapësira e siguruar, punëtori i sigurimit duhet menjëherë të njoftojë Policinë e Kosovës.</p> <p>6.Kufizimi i lëvizjes së personit apo automjetit lejohet vetëm deri në arritjen e policisë.</p> <p>7.Punëtorët e sigurimit duhet të përdorin forcën vetëm në pajtim me këtë Ligj.</p> <p>8.Punëtorët e sigurimit duhet të përdorin vetëm pajisjet e sigurimit të autorizuara nga Organi Kompetent ose në pajtim me këtë ligj.</p> <p>9.Zyrtarët e zbatimit të ligjit përjashtohen nga kontrollimi që e bëjnë punëtorët e sigurimit në këto raste:</p> <p>9.1.Gjatë inspektimit të hapësirës së sigurisë;</p> <p>9.2.Nëse është në posedim të urdhër arrestit ose autorizimit të vlefshëm;</p> <p>9.3.Në situata emergjente.</p>	<p>4.A Security Worker may only hold a person if they suspect the person has committed, is in the process of committing, or is about to commit a criminal offence.</p> <p>5.If a Security Worker prohibits a person or vehicle exit from a Secure Area, the Security Worker must immediately inform the Kosovo Police.</p> <p>6.Limitation of movement of a person or vehicle is only allowed until the arrival of the police.</p> <p>7. Security Workers must only use force in accordance with this Law.</p> <p>8.Security Workers must only use Security Equipment authorised by the Competent Body and only in accordance with this law.</p> <p>9.Law enforcement officials are exempt from controls by Security Workers in the following cases:</p> <p>9.1.During an inspection of a Secure Area;</p> <p>9.2.If in possession of a valid search warrant or authorisation;</p> <p>9.3. In an emergency situation.</p>	<p>4.Radnik obezbeđenja može da zadrži lica samo ako sumnja da je lice izvršio ili će izvršiti krivični delo.</p> <p>5.Ako radnik obezbeđenja zabrani zaostavla izlaz lica ili vozila iz prostora obezbeđenja, radnik obezbeđenja treba odmah da informiše Kosovsku Policiju.</p> <p>6.Ograničenje kretanja lica illi vozila dozvoljava se samo do pristizanja policije.</p> <p>7.Radnici obezbeđenja treba da primenjuju silu u skladu sa ovim Zakonom.</p> <p>8.Radnici obezbeđenja treba primeniti samo ovlašćenu opremu obezbeđenja od Nadleznog Organa i u skladu sa ovim Zakonom.</p> <p>9.Službenici za sprovođenje zakona i službe se isključuju iz kontrole koju vrše radnici obezbeđenja u sledećim slučajevima:</p> <p>9.1.Prilikom inspektovanja prostora obezbeđenja;</p> <p>9.2.Ako je u posedu nalog zs pritvor ili važećeg ovlašćenja;</p> <p>9.3.U emergentnoj situaciji.</p>
---	---	--

<p>10.Në raste urgjente, shërbimet e urgjencës përjashtohen nga kontrollet e punëtorëve të sigurisë.</p> <p>11.Punëtorët e sigurimit duhet të identifikohen para policisë në bazë të kërkesës.</p> <p>12.Organi Kompetent me akt nënligjor përcakton autorizimet dhe detyrat e punëtorëve të sigurimit në pajtim me këtë Ligj.</p>	<p>10.In the case of emergency, emergency services are exempt from controls by Security Workers.</p> <p>11.Security Workers shall identify themselves to the Police upon request.</p> <p>12. The Competent Body shall issue sub-legal act determining authorizations and duties of Security Workers in accordance with this Law.</p>	<p>10.U hitnim slucajevima , hitne usluge isključuju se od kontrole radnika obezbeđenja.</p> <p>11.Radnici obezbeđenja treba da se identifikuju pred Policijom na njen zahtev.</p> <p>12.Nadležni Organ sa podzakonskim aktom utvrđuje ovalšćenja i zadatke radnicima obezbeđenja u skladu sa ovim Zakonom.</p>
<p>Neni 29 Përdorimi i forcës</p>	<p>Article 29 Use of Force</p>	<p>Član 29 Primena sile</p>
<p>1.Punëtori i sigurimit mund të ushtrojë përdorimin e forcës vetëm që të mbrojnë vetëvetën ose të tjerët, kundër kërcënimit të pashmangshëm për vdekje ose lëndim serioz, përvec rasteve të përcaktuara në paragrafin 9, pika 9.1, 9,2 dhe 9.3 të këtij neni.</p> <p>2.Përdorimi i forcës duhet të jetë proporcionale me kërcënimin e vërtetë.</p> <p>3.Punëtori i sigurimit ka obligim që para se të përdorë forcën të tërheqë vërejtjen për këtë. Përjashtim është rasti i sulmit të papritur në punëtorin e sigurimit ose të tjerët që paraqet kërcënim të pashmagshëm</p>	<p>1. A Security Worker may exercise the use of force only to defend oneself or others against the imminent threat of death or serious injury. An exemption to this is Step 1, Step 2 and Step 3 of the Use of Force Continuum outlined in Paragraph 9 of this Article.</p> <p>2. The use of force must be proportional to the actual threat posed.</p> <p>3. A Security Worker has an obligation to warn that he/she will use force prior to the use of such force. An exception to this is in the case of a sudden attack on a Security Worker or others which poses an imminent</p>	<p>1.Radnik obezbeđenja može da primeni silu samo da odbrani sebe ili druge od neizbežne pretnje za život ili od ozbiljne povrede osim slucajevima odredjenim u stavu 9 tacka 9.1,9.2 i 9.3 ovog Člana.</p> <p>2.Primena sile treba da bude srazmerno stvarne pretnje.</p> <p>3.Radnik obezbeđenja obzen je, da pre nego upotrebi silu da skrene pažnju u vezi toga. Izuzetak čini slučaj neočekivanog napada na radnika obezbeđenja ili na napad drugih koji predstavlja neizbežnu</p>

<p>për vdekje ose lëndim serioz.</p> <p>4.Punëtorëve të sigurimit iu ndalohet përdorimi i forcës kundër femrave shtatzëna, fëmijëve, të moshuarëve dhe personave të paaftë, përveq nëse paraqet kërcënim të pashmagshëm për vdekje ose lëndim serioz.</p> <p>5.Punëtori i sigurimit gjatë përdorimit të forcës duhet të minimizojë kufizimin e ndërhyrjen në të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të minimizojë çfarëdo pasoje dëmtuese.</p> <p>6. Përdorimi i forcës, si term i përdorur në këtë Ligj, përfshinë por nuk është i kufizuar në përdorimin e forcës fizike, pajisjeve të sigurisë dhe të armës së autorizuar.</p> <p>7. Nëse është përdorur forca, atëherë punëtori i sigurimit është i obliguar të njoftojë Policinë e Kosovës.</p> <p>8. Secili përdorim i forcës nga ana e punëtorit të sigurimit duhet të jetë subjekt i hetimit nga policia, për të vërtetuar nëse përdorimi i forcës ishte proporcional me kërcënimin e paraqitur.</p> <p>9.Punëtorët e sigurimit duhet të përdorin forcën në vazhdimësi në këto raste, përveç në rast të sulmit të papritur i cili paraqet</p>	<p>threat of death or serious injury.</p> <p>4. Security Workers are prohibited from using force against pregnant women, children, elderly and disabled people, except where there is an imminent threat of death or serious injury.</p> <p>5. When using force, a Security Worker must minimize the intrusion into a person's rights and freedoms and to minimize any detrimental consequences.</p> <p>6. Use of force, as the term is used in this Law, includes, but is not limited to the use of physical force, Security Equipment and Authorized firearms.</p> <p>7. If force is used, a Security Worker has the obligation to inform the Kosovo Police immediately.</p> <p>8. Every use of force by a Security Worker must be subject to an investigation by the police to identify whether or not the use of force was proportionate to the threat posed.</p> <p>9. Security Workers must make use of the following use of force continuum, unless in the case of a sudden attack which poses</p>	<p>pretnju za život ili ozbiljnu povredu.</p> <p>4.Radnicima obezbeđenja se zabrani primena sile protiv žena trudnice, dece, starih i nesposobnih lica, osim koji predstavlja neizbežnu pretnju za život ili ozbiljnu povredu</p> <p>5.Prilikom primene sile, radnik obezbeđenja treba minimizirati ograničenje i upletanje u pravima i slobodama čoveka i minimizira bilo koju štetnu posledicu.</p> <p>6.Primena sile, kao upotrebljeni pojam u ovom Zakonu, obuhvati ali neograničava se na primenu fizičke sile, opreme obezbeđenja i ovlašćenih oružja.</p> <p>7.Ako je upotrebljena sila, u tom slučaju radnik obezbeđenja obavezan je da informiše Kosovsku Policiju.</p> <p>8.Saaka primena sile od strane radnika obezbeđenja, treba da bude predmet istrage od policije radi utvdjivanja da li primena sile je srazmerna pretnji.</p> <p>9.Radnici obezbeđenja treba da primene silu postepenog u ovim slucajevima ,osim u slučaju neočekivanog napada koji</p>
--	---	---

<p>kërcënim të pashmangshëm për vdekje ose lëndim serioz:</p> <p>9.1.Hapi i parë – prezenca –prania e punëtorit të sigurimit ndaj personit;</p> <p>9.2.Hapi i dytë – thirrja verbale – thirrja e personit duke tërhequr vërejtjen;</p> <p>9.3.Hapi i tretë – kontrolli përmes duarëve të hapura – përdorimi i duarëve të hapura për të kontrolluar apo imobilizuar personin;</p> <p>9.4.Hapi i katërt – përdorimi i shkopit të sigurisë – është e lejueshme vetëm në pjesët muskulore të duarëve dhe këmbëve të personit;</p> <p>9.5.Hapi i pestë – forca vdekjeprurëse – përdorimi i forcës që mund të shkaktojë lëndim të përhershëm ose vdekje të personit.</p> <p>10.Përdorimi i forcës në vazhdimësi duhet të ndërpritet në momentin kur punëtori i sigurimit e ka situatën nën kontroll.</p> <p>11.Organi Kompetent me akt nënligjor përcakton mënyrën e përdorimit të forcës nga ana e punëtorëve të sigurimit në pajtim me këtë Ligj.</p>	<p>an imminent threat of death or serious injury:</p> <p>9.1. Step one - Presence - using the effect of the presence of the Security Worker on a subject;</p> <p>9.2. Step two - Verbal Commands - commanding a subject using warnings;</p> <p>9.3. Step three - Open hand control - using open hands to immobilize, or otherwise control a subject;</p> <p>9.4. Step four - Use of a Security Baton - this is only allowed on the muscular parts of the arms and legs of a subject;</p> <p>9.5. Step five - Lethal force - using any force which may cause permanent injury or death to a subject.</p> <p>10. The use of force continuum must be stopped at the moment the Security Worker has the situation under control.</p> <p>11. The Competent Body shall issue sub-legal act detailing the use of force by Security Workers in accordance with this Law.</p>	<p>predstavljja neizbeznu pretnju za smrt ili ozbiljnu povredu:</p> <p>9.1.Prvi korak-prisustvo - prisustva radnika obezbeđenja prema licu;</p> <p>9.2.Drugi korak- usmena komanda-komandovanje lica uz skretanje pažnje;</p> <p>9.3.Treći korak- kontrola uz ispružanih ruku- upotreba ispružanih ruku za imobilizaciju subjekta, ili za kontrolu lica;</p> <p>9.4.Četvrti korak-upotreba palice obezbeđenja- to je dozvolivo samo na mišićne delove ruku i nogu lica;</p> <p>9.5.Peti korak- smrtnonosna sila-upotreba sile koja može da nanosi stalnu povredu ili smrt lica.</p> <p>10.Primena sile uz stalno povećanje, treba da se prekine u trenutku kada radnik obezbeđenja ima situaciju pod kontrolom.</p> <p>11.Nadležni Organ sa pozakonskim aktom reguliše način pojedinosti primene sile od strane radnika obezbeđenja u skladu sa ovim Zakonom.</p>
---	--	---

<p align="center">Neni 30 Bartja dhe përdorimi i armëve të zjarrit</p>	<p align="center">Article 30 Carrying and use of firearms</p>	<p align="center">Član 30 Nošenje i upotreba vatrenog oružja</p>
<p>1.Operatorët e mbrojtjes së afërt dhe rojet e TPG-së, të licensuar mund të jenë të armatosur vetëm në pajtim me këtë Ligj dhe Ligjin për Armë.</p> <p>2. Operatorët e mbrojtjes së afërt dhe rojet e TPG-së, të licensuar mund të armatosen vetëm si vijon:</p> <p>2.1.Armët e zjarrit të autorizuara për operatorët e mbrojtjes së afërt janë kategori B1 siç është përcaktuar me Ligjin për Armë, por e kufizuar në pistoletat me velenxën mekanike të sigurisë, tytë konvencionale dhe municion të kalibrit 9 x 19 mm me gëzhjojë nga metali i plotë.</p> <p>2.2.Armët e autorizuara për rojet e TPG-së, janë kategori B1 siç është përcaktuar në Ligjin për Armë me velenxën mekanike të sigurisë, tytë konvencionale dhe municion të kalibrit 9 x 19mm me me gëzhjojë nga metali i plotë, me përjashtim të pistoletave.</p> <p>3. Operatorët e mbrojtjes së afërt dhe rojet e TPG-së, të licensuar mund të armatosen vetëm me armë të autorizuara dhe bartin vetëm kur janë në detyrë.</p>	<p>1.Licensed Close Protection Operatives and CIT Guards may only be armed in accordance with this Law and the Law on Weapons.</p> <p>2.Licensed Close Protection Operatives and CIT Guards may only be armed as follows:</p> <p>2.1.Authorised firearms for Close Protection Operatives are Category B1 as defined in the Law on Weapons but limited to pistols with a mechanical safety pall, conventional barrels and ammunition of calibre 9 x 19 mm full metal jacket.</p> <p>2.2.Authorised firearms for CIT Guards are Category B1 as defined in the Law on Weapons with a mechanical safety pall, conventional barrels and ammunition of calibre 9 x 19 mm full metal jacket, excluding revolvers.</p> <p>3.Licensed Close Protection Operatives and CIT Guards may only be armed with authorized firearms and only when on duty.</p>	<p>1.Operativci licencirani za blisku odbranu i čuvari TGN-a mogu biti naoružani u skladu ovim Zakonom i sa Zakonom o Oružju.</p> <p>2.Licencirani operativci za blisku odbranu i čuvari TGN-a mogu biti naoružani samo kako sledi:</p> <p>2.1.Vatrenom oružjem ovlašćeno za operative bliske odbrane iz kategorije B1 kako je definisano Zakonom o oružju ali ograničeno na pištolje mehaničke valencije bezbednosti, konvencionalnih cevi klibra 9 x 19 mm, čaurom od potpunog metala.</p> <p>2.2.Ovlašćeno oružje za čuavre TGN-a iz kategorije B1 kako je definisano Zakonom o Oružju, mehničke valencije bezbednosti, konvencionalnih cevi i municije kalibra 9 x 19 mm, čaure od potpunog metala, izuzev pištolja;</p> <p>3. Licencirani operativci za blisku odbranu i čuvari TGN-a mogu biti naoružani samo ovlašćenom i nosi oružjem i samo kada su na dužnost.</p>

<p>4.Operatorët e mbrojtjes së afërt dhe rojet e TPG-së, mund të përdorin armën e tyre të autorizuar vetëm si zgjidhje e fundit kur mjetet tjera janë të pamjaftueshme për të mbrojtur veten ose të tjerët nga sulmi i pashmangshëm për jetë.</p> <p>5.Për përdorimin e armës së autorizuar të zjarrit, duhet të ndiqen hapat si në vijim:</p> <p>5.1.Hapi i parë – nxjerrja e armës së zjarrit;</p> <p>5.2.Hapi i dytë – tërheqja e vërejtjes së personit, se punëtori i sigurimit do të shtiejë dhe futja e plumbit në armën e zjarrit;</p> <p>5.3.Hapi i tretë – drejtimi i armës së zjarrit në personin;</p> <p>5.4.Hapi i katërt - lirimi i velenxës së sigurisë;</p> <p>5.5.Hapi i pestë – të shtënit me armë të zjarrit.</p> <p>6.Kompania Private e Sigurimit dhe operatori i mbrojtjes së afërt ose roja e TPG-së, janë të obliguar të nftojnë Policinë e Kosovës menjëherë pasi është shtënë me armën e zjarrit. Punëtori i sigurimit që ka shtënë me armën e zjarrit nuk duhet të largohet nga detyra deri sa të ipet leja për këtë nga policia.</p>	<p>4.Close Protection Operatives and CIT Guards can only use their authorized firearms as a measure of last resort when less extreme means are insufficient to defend themselves or others from an imminent attack on life.</p> <p>5. When using an authorised firearm there are five steps which must be followed:</p> <p>5.1. Step one - Drawing the firearm;</p> <p>5.2. Step two - Warning the subject that the Security Worker will fire and chambering a bullet in the firearm;</p> <p>5.3. Step three - Pointing the firearm at the subject;</p> <p>5.4. Step four - Disengaging the safety pall;</p> <p>5.5. Step five - Discharging the firearm.</p> <p>6.A Private Security Company and a Close Protection Operative or CIT Guard are obliged to inform the Kosovo Police immediately when a firearm has been discharged. The Security Worker who discharged their firearm must not be released from duty until given permission to do so by the Police.</p>	<p>4. Operativci bliske odbrane i çuvari TGN-a mogu upotrebiti njihovo ovlašćeno oružje, samo kao zadnje rešenje, kada sredstva manjeg efekta su nedovoljna za sopstvenu odbranu ili odbranu drugih od neizbežnog napada po život.</p> <p>5.Kada se upotrebi ovlašćeno oružje treba da se poštuju sledeći koraci:</p> <p>5.1.Prvi korak vađenje vatrenog oružja;</p> <p>5.2.Drugi korak- skretanje pažnje subjektu da radnik obezbeđenje će pucati i ubacivanje metka u vatreno oružje;</p> <p>5.3.Treći korak-usmerenje vatrenog oružja na subjekta;</p> <p>5.4.Četvrti korak- oslobađanje valencije bezbednosti;</p> <p>5.5.Peti korak- pucanj vatrenim oružjem.</p> <p>6.Privatne Kompanija Obezbeđenja i operativac za blisku odbranu ili çuvar TGN-a su obavezni da informišu Kosovku Policiju, odmah nakon pucnja vatrenom oružjem. Radnik obezbeđenja koji je pucao vatrenom oružjem ne treba da se udaljava od mesta događaja dok se ne dozvoli od Policije.</p>
---	--	--

<p>7.Çdo e shtënë nga arma e zjarrit nga ana e punëtorit të sigurimit, e qëllimshme apo e rastësishme do të jetë subjekt i një hetimi të menjëhershëm nga Policia e Kosovës dhe të gjeturat e një hetimi të tillë do të jepen në një raport të detajuar.</p> <p>8.Nëse hetimi i Policisë së Kosovës nga paragrafi 7 i këtij neni, zbulon se e shtëna nga arma e zjarrit nuk ishte në pajtim me këtë Ligj, atëherë punëtorit të sigurimit menjëherë do t'i hiqet licenca.</p> <p>9.Punëtorit të sigurimit i cili posedon armë të paautorizuar të zjarrit, sa është në detyrë, menjëherë do t'i heqet licenca. Nëse konstatohet përgjegjësia, licenca mund t'i heqet edhe Kompanisë Private të Sigurimit.</p> <p>10.Organi Kompetent me akt nënligjor përcakton mënyrën dhe përdorimin e armës të zjarrit nga punëtorët e sigurimit si dhe magazinimi dhe trajtimi nga Kompanitë Private të Sigurimit në pajtim me këtë Ligj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 31 Qentë e sigurimit</p> <p>1.Përdorimi i qenëve të sigurimit lejohet vetëm për aktivitetet e shërbimit të</p>	<p>7. Every discharge of a firearm by a Security Worker, whether intentional or unintentional, will be the subject of an immediate investigation by the Kosovo Police and the findings of such an investigation will be detailed in a report.</p> <p>8. In the event that the investigation by the Kosovo Police in paragraph 7 of this Article finds that the discharge of a firearm was not in accordance with this Law, the Security Worker will immediately have their Licence revoked.</p> <p>9.A Security Worker in possession of an unauthorised firearm whilst on duty, will immediately have their License revoked. If the responsibility is ascertained, the Private Security Company may have its licence revoked also.</p> <p>10. The Competent Body shall issue sub-legal act detailing the use of firearms by Security Workers and the Storage and handling of firearms by Private Security Companies in accordance with this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 31 Security Dogs</p> <p>1.Use of Security Dogs is permitted for the activity of basic security services only.</p>	<p>7.Svaki pucanj vatrenim oružjem od strane radnika obezbeđenja, namernog ili slučajnog će biti predmet bezodložne istrage od Kosovske Policije i nalazi istrage će se prikazati detaljnim izveštajem.</p> <p>8.Ako istraga Kosovske Policije iz stava 7 ovog člana, otkrije da pucanj vatrenim oružjem nije u skladu sa ovim Zakonom, tada radniku obezbeđenja odmah će mu se oduzimati licenca.</p> <p>9.Radniku obezbeđenja u posedu neovlašćenog vatrenog oružja dok je u zadatku odmah će mu se oduzimati licenca ako se konstatuje odgovornost , oduzimanje licence će biti i za Privatne Kompanije Obezbeđenja.</p> <p>10.Nadležni Organ sa podzakonskim aktom otvrđuje nacim i upotrebu vatrenog oružja od radnika obezbeđenja kao i uskladištenje i tretiranje istog od Privatne Kompanije Obezbeđenja u skladu sa ovim Zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 31 Psi za obezbeđenje</p> <p>1.Upotreba pasa obezbeđenja dozvoli se samo za aktivnost zaštite imovine.</p>
--	---	---

<p>sigurimit themelor.</p> <p>2.Kompania Private e Sigurimit duhet të posedojë një polisë sigurimi për përdorimin e qenëve të sigurimit.</p> <p>3.Kompania Private e Sigurimit mban të dhëna për secilin qen të sigurimit. Të dhënat për secilin qen të sigurimit do të përfshijnë informatat minimale si në vijim:</p> <p>3.1. Të dhënat e prejardhjes (përfshirë pedigren) e qenit të sigurimit;</p> <p>3.2. Emri, lloji, mosha, ngjyra, gjinia;</p> <p>3.3. Të dhënat e pronarit;</p> <p>3.4. Të dhënat e vaksinimit;</p> <p>3.5. Të dhënat e mikroçipit të qenit të sigurimit;</p> <p>3.6.Të dhënat e çfarëdo trajtimi veterinar;</p> <p>3.7. Të dhënat e trajnimeve;</p> <p>3.8. Raportet e incidentit;</p> <p>3.9. Raportet e kafshimit;</p> <p>3.10.Çfarëdo certifikate e transferit të pronësisë.</p> <p>4.Secili qen i sigurimit do të ketë të insertuar një mikroçip për qëllime të identifikimit. Mikroçipi i insertuar duhet të jetë në pajtim me Standardet Profesionale të Kosovës.</p> <p>5.Qentë e sigurimit do të trajnohen dhe licensohen në pajtim me Standardet</p>	<p>2. A Private Security Company must have an insurance policy for the use of Security Dogs.</p> <p>3.A Private Security Company will keep canine records for each Security Dog. The canine record for each Security Dog will include the following information, as a minimum:</p> <p>3.1. Data on procurement (including pedigree) of the Security Dog;</p> <p>3.2. name, breed, age, colour, sex;</p> <p>3.3. Data on the owner;</p> <p>3.4. Vaccination details;</p> <p>3.5. Data on the Security Dog’s microchip,</p> <p>3.6. Data on any veterinary treatment;</p> <p>3.7. Training records,</p> <p>3.8. Incident reports,</p> <p>3.9. Bite reports;</p> <p>3.10. Any transfer of ownership certificates.</p> <p>4.Every Security Dog will have a microchip inserted for identification purposes. The microchip inserted must comply with the Kosovo Professional Standards.</p> <p>5.Security Dogs will be trained and licensed in accordance with the Kosovo</p>	<p>2. Privatna Kompanija Obezbeđenja treba da poseduje polisom osiguranja za upotrebu pasa obezbeđenja.</p> <p>3.Privatna Kompanija Obezbeđenja će voditi podatke o svakom psetu obezbeđenja. Podaci o svakom psetu obezbeđenja će obuhvatiti minimum sledeće informacije:</p> <p>3.1.Podatke o nabavke (uključujući pdigrea) pasa obezbeđenja;</p> <p>3.2.Ime, vrsta, uzrast, boja , pol;</p> <p>3.3.Poodatke o vlasnika;</p> <p>3.4.Podatke o vakcinisanju pasa;</p> <p>3.5.Podatke mikričipa pasa obezbeđenja;</p> <p>3.6.Podatke bilo kog veterinarskog tretiranja;</p> <p>3.7.Podaci obuke;</p> <p>3.8.Izveštaj incidenta;</p> <p>3.9.Izveštaj ujeda;</p> <p>3.10.Bilo koji transfer sertifikata vlasništva.</p> <p>4.Svaki pas obezbeđenja imaće insertiran mikroçip u cilju identifikacije. Insertirani mikroçip treba da bude u skladu sa Stručnim Standardima Kosova.</p> <p>5.Psi za obezbeđenje će se obučavati i licencirati u skladu sa Stručnim</p>
---	---	---

<p>Profesionale të Kosovës. 6.Qentë e sigurimit duhet të mbahen gjatë gjithë kohës sa janë në detyrë nga mbajtësi i qenit.</p> <p>7.Mbajtësi i qenit, gjatë manovrimit me qenin specifik, do të jetë në posedim të kartelës identifikuese e cila përmban informatat themelore për qenin specifik të sigurimit me të cilin ai/a jo po manovron.</p> <p>8.Qeni i sigurimit duhet të mbahet i lidhur dhe të bartë mbrojtësen në gojë gjatë tërë kohës që është në kontakt të drejtpërdrejt me publikun në harmoni me Standardet Profesionale të Kosovës.</p> <p>9.Kushtet tjera për qentë e sigurimit përcaktohen në Standardet Profesionale të Kosovës.</p>	<p>Professional Standards. 6. Security Dogs must be handled by a Dog-handler whilst on duty at all times.</p> <p>7.A Dog handler, while handling a specific dog, will be in possession of an identity card which contains basic information about the specific Security Dog he/she is handling.</p> <p>8.A Security Dog must be kept on a leash and wear a muzzle at all times when it is in direct contact with the public in line with the Kosovo Professional Standards.</p> <p>9.Further requirements for Security Dogs will be outlined in the Kosovo Professional Standards.</p>	<p>Standardima Kosova. 6.Psi za obezbeđenje treba da manevrisaju u toku celog vremena od držalaca pasa dok su na radu.</p> <p>7.Držalac pasa, u toku manevrisanja specifičnog pasa, bi će u posedu identifikacione kartice koja sadrži osnovne informacije o specifičnom pasu obezbeđenja kojim on ili ona manevriše.</p> <p>8.Pas obezbeđenja treba da se drži uz užeta da nosi zaštitu usta u toku celog vremena kada je u neposrednom kontaktu sa publikom, saglasno Stručnim Standardima Kosova.</p> <p>9.Drugi uslovi za pse obezbeđenja će se predvideti Stručnim Standardima Kosova.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 32 Pajisjet e sigurimit</p> <p>1.Pajisjet e sigurimit që janë të lejuara nga Organi Kompetent mund të përdoren nga punëtorët e sigurimit.</p> <p>2.Punëtorëve të sigurimit do t’iu ofrohen pajisjet e domosdoshme nga Kompania Private e Sigurimit që i punëson për t’i përmbushur detyrat e tyre.</p>	<p style="text-align: center;">Article 32 Security Equipment</p> <p>1.Only Security Equipment approved by the Competent Body may be used by Security Workers.</p> <p>2. Security Workers shall be provided with the necessary equipment to accomplish their duties by the Private Security Company which employs them.</p>	<p style="text-align: center;">Član 32 Oprema obezbeđenja</p> <p>1. Samo oprema odobrena od Nadležnog Organa, može da se upotrebi od radnika obezbeđenja.</p> <p>2. Radnicima obezbeđenja se pruža neophodna oprema od Privatne Kompanije Obezbeđenja koja ih zapošljava za vršenje njihovih zadataka.</p>

<p>3.Pajisja e sigurimit duhet të përdoret nga punëtorët e sigurimit vetëm për aktivitetet e sigurimit për të cilin ata janë licensuar.</p> <p>4. Pajisjet e sigurimit duhet të kategorizohen si vijon:</p> <p>4.1.Jelekët antiplumb, gas maskat, prangat, shkopi i sigurisë, dylbit, detektorët e metalit që kalohet përmes tyre dhe të dorës, mengelet e rrotës dhe mjetet audio do të jenë në dispozicion për të gjithë punëtorët e sigurimit.</p> <p>4.2.Alarmet kundër futjes së paautorizuar, sistemet e kontrollit për qasje elektronike dhe pajisjet e TV-ve, të qarkut të mbyllur, pajisjet për vëzhgim optik do të jenë të kufizuara për operatorët e mbikëqyrjes elektronike.</p> <p>4.3.Helmetat, mjetet e përcjelljes, automjetet e blinduara dhe automjetet për përcjellje do të jenë të kufizuara për rojet e TPG-së.</p> <p>5.Organi Kompetent me akt nënligjor përcakton standardet e kërkuara, aprovimin, evidentimin, ruajtjen dhe përdorimin e pajisjeve të sigurimit.</p>	<p>3. Security Equipment must be used by Security Workers only in the activity of security for which they are licensed.</p> <p>4. Security Equipment shall be categorised as follows:</p> <p>4.1.Bullet proof vests, gas masks, handcuffs, security baton, binoculars, walkthrough and handheld metal detectors, wheel clamps and audio devices will be available to all Security Workers.</p> <p>4.2.Intruder alarms, electronic access control systems and CCTV equipment, optical surveillance equipment will be limited to Electronic Surveillance Operators.</p> <p>4.3.Helmets, tracking devices, armoured vehicles and escort vehicles will be limited to CIT Guards.</p> <p>5. The Competent Body will issue a sub-legal act on required standards, approval, evidencing, storing and use of Security Equipment.</p>	<p>3. Oprema za obezbeđenje treba da se upotrebi od radnika obezbeđenja samo za aktivnost obezbeđenja za koju su licencirani.</p> <p>4. Oprema za obezbeđenje treba da se kategorizuje kako sledi:</p> <p>4.1.Antikuršumski prsluk, palice obezbeđenja, dvogled, metalni detektori koji prođu preko njih i ruku, mengele točkova i audio sredstva će biti na raspolaganju svim radnicima obezbeđenja;</p> <p>4.2.Alarmni uređaj za neovlašćeni ulaz, za sisteme kontrole za elektronski pristup i TV uređaju zatvorenog kruga, oprema za optičko izviđanje i sredstva za izviđanje podataka, će biti ograničena za operator elektronskog nadgledanje.</p> <p>4.3.Kacige, sredstva istrage, blidirana vozila i vozila pratnje će biti ograničena za čuvare TGN-a;</p> <p>5. Nadležni Organ sa podzakonskim aktom utvrđuje tražne standarde, odobravanje, nabavku, evidenciju, čuvanje i upotrebu opreme obezbeđenja.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 33 Njoftimi i policisë dhe/ose shërbimeve të emergjencës</p> <p>1. Punëtori i sigurimit që ia kufizon lëvizjet personit duke përdorur forcën e çfarëdo lloji, menjëherë duhet të informojë Policinë e Kosovës, personalisht ose përmes qendrës së tij/saj të kontrollit.</p> <p>2. Punëtori i sigurimit që i shkakton lëndime personit duhet të sigurohet se pala e lënduar do të marrë ndihmën mjekësor menjëherë.</p> <p>3. Përveç që është përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, Kompania Private e Sigurimit duhet brenda 24 orësh të raportojë me shkrim te Organi Kompetent për çfarëdo incidenti që përfshin kufizimin e lëvizjes ose lëndimin e personit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 33 Notification of police and/or emergency services</p> <p>1. A Security Worker who limits the movement of a person by using force of any description must immediately inform the Kosovo Police personally or through his/her Control Centre.</p> <p>2. A Security Worker who causes injury to a person will ensure the injured party receives medical assistance immediately.</p> <p>3. In addition to paragraph 1 and 2 of this Article a Private Security Company must, within 24 hours, report in writing to the Competent Body, any incident involving limitation of movement or injury to a person.</p>	<p style="text-align: center;">Član 33 Najava policije i/ili emergentne službe</p> <p>1. Radnik obezbeđenja koji ograničuje kretanje lice upotrebom sile svih vrsta, odmah treba najaviti Kosovsku Policiju lično ili preko njegovog/njenog kontrolnog centra.</p> <p>2. Radnik obezbeđenja koji nanosi povrede licu, treba da se obezbedi da povređena stranka primi lekarsku pomoć.</p> <p>3. Kako je predviđeno u stavu 1 i 2 ovog člana, Privatne Kompanija Obezbeđenja treba u roku od 24 časova da pismeno isvesti Nadležnog Organa o bilo kom incidentu koju obuhvata, krejtanje ili povredu lica.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 34 Njoftimi për vepër penale</p> <p>Nëse punëtori i sigurimit dyshon se një vepër penale ka ndodhur, po ndodh ose do të ndodh, atëherë duhet menjëherë të njoftojë Policinë e Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 34 Notification of criminal offence</p> <p>If a Security Worker suspects that a criminal offence has occurred, is occurring, or is about to occur, they must immediately inform the Kosovo Police.</p>	<p style="text-align: center;">Član 34 Obaveštenje o krivičnom delu</p> <p>Ako radnik obezbeđenja sumnja da krivični delu se desilo, se dešava ili će se desiti, tada treba odmah obavesti Kosovsku Policiju.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 35 Kartelat zyrtare të identifikimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 35 Official Identification Cards</p>	<p style="text-align: center;">Član 35 Službene identifikacione kartice</p>
<p>1. Me kërkesën e Kompanisë Private të Sigurimit, Organi Kompetent do të lëshojë kartela zyrtare të identifikimit për të gjithë punëtorët e tyre të sigurimit dhe shpenzimet do të barten nga Kompania Private e Sigurimit.</p>	<p>1. Upon their request, the Competent Body will issue Official identification cards to a licensed Private Security Company, for all its employed Security Workers. and the expenses will be borne by the Private Security Company.</p>	<p>1. Uz zahtev Privatne Kompanije Obezbeđenja Nadležni Organ će izdati službene identifikacione kartice za sve radnike obezbeđenja a troškove će snositi Privatne Kompanije Obezbeđenja.</p>
<p>2. Punëtori i sigurimit në pajtim me këtë Ligj gjatë kryerjes së detyrave të tij duhet të bart kaltelen zyrtare identifikuese në vend të dukshëm.</p>	<p>2. A Security Worker, in accordance with this Law, shall possess and prominently display an official identification card during the performance of their duties.</p>	<p>2. Radnik obezbeđenja u skladu sa ovim Zakonom će nositi na vidno mesto službenu identifikacionu karticu u toku vršenja njegove dužnosti.</p>
<p>3. Operatorët e mbrojtjes së afërt duhet të bartin kartelën zyrtare të identifikimit, mirëpo mund që mos ta ekspozojnë atë.</p>	<p>3. Close Protection Operatives shall possess an official identification card, but may not need to visually display the card.</p>	<p>3. Operativci bliske odbrane će raspolagati službenom identifikacionom karticom ali mogu da je ne izlažu.</p>
<p>4. Nëse punëtori i sigurimit e ndërpre mardhënien e punës me Kompaninë Private të Sigurimit, menjëherë duhet ta kthejë kartelën zyrtare identifikuese të tij në Kompaninë Private të Sigurimit.</p>	<p>4. If a Security Worker stops working for a Security Company, they must immediately return their card to the Private Security Company.</p>	<p>4. Ako radnik obezbeđenja prestaje sa radom pri Privatne Kompanije Obezbeđenja, tada treba odmah da vrati njegovu službenu identifikacionu karticu Privatne Kompaniji Obezbeđenja.</p>
<p>5. Kompania Private e Sigurimit duhet të kthejë kartelën zyrtare të identifikimit te Organi Kompetent brenda 24 orëve.</p>	<p>5. The Private Security Company shall return the official identification card to the Competent Body within 24 hours.</p>	<p>5. Privatne Kompanija Obezbeđenja treba da vrati istu službenu identifikacionu karticu Nadležnom Organu u roku od 24 časova.</p>
<p>6. Organi kompetent me akt nënligjor përcakton procedurat e lëshimit të kartelës</p>	<p>6. The Competent body shall issue a sub-legal act determining the procedures</p>	<p>6. Nadležni organ sa podzakonskim aktom utvrđuje postupke u vezi izdavanja</p>

<p>zyrtare të identifikimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 36 Uniforma, shenjat dalluese dhe emblemat</p> <p>1. Punëtorët e sigurimit duhet të kenë të veshur uniformat e punës gjatë tërë kohës sa janë në detyrë.</p> <p>2. Uniformat do të posedojnë amblemat ose shenjat dalluese të Kompanisë Private të Sigurimit. Amblemat, shenjat dhe përshkrimi i uniformave të punës i dorëzohen Organit Kompetent për aprovim bashkë me aplikacionin për licensim për ofrimin e shërbimeve të sigurimit.</p> <p>3. Uniformat e punës, shenjat dalluese dhe emblemat, si tërësi, nuk duhet t'i ngjajnë uniformave të institucioneve të autorizuara shtetërore të sigurisë.</p> <p>4. Sinjalet zanore dhe ndriçuese nuk duhet t'u ngjajnë atyre të institucioneve të autorizuara shtetërore të sigurisë.</p> <p>5. Kompania Private e Sigurimit mund të autorizojë operatorët e mbrojtjes së afërt që të mos veshin uniformë.</p>	<p>relating to the official identification cards.</p> <p style="text-align: center;">Article 36 Uniforms, signs and emblems</p> <p>1. Security Workers shall wear working uniforms at all times while on duty.</p> <p>2. The uniforms shall possess emblems or distinctive signs of the Private Security Company. Emblems, signs and a description of the working uniforms shall be submitted to the Competent Body for approval, together with the application for a Licenses to provide Security Services.</p> <p>3. Working uniforms, signs and emblems as entirety shall not resemble uniforms worn by authorized state security institutions.</p> <p>4. The voice and sheeny signals shall not resemble to those of authorized state security institutions.</p> <p>5. A Private Security Company may authorise Close Protection Operatives to dress in non uniform clothing.</p>	<p>službenih identifikacionih kartica.</p> <p style="text-align: center;">Član 36 Uniforme znakovi raspoznavanja i ambleme</p> <p>1. Radnici obezbeđenja će nosti radnu uniformu u toku celog vremene dok su na dužnost.</p> <p>2. Uniforme će nositi logoa ili oznake Privatne Kompanije Obezbeđenja. Logo, oznake i opis radnih uniformi će se dostaviti Nadležnom Organu na usvajanje zajedno sa početnom aplikacijom za licencu za pružanje usluga obezbeđenja.</p> <p>3. Radne uniforme ne znakovi raspoznavanja i ambleme u celini ne treba da liče na uniforme koje nose ovlašćene institucije obezbeđenja.</p> <p>4. Zvucni znakovi i osvetljavajuci ne treba da liče na ovlašćene derzavne institucije za obezbedjenje</p> <p>4. Privatne Kompanija Obezbeđenja može da ovlasti operative za blisku odbranu da nose neuniformisanu odeću.</p>
---	---	--

<p align="center">Neni 37 Trajnimi themelor profesional</p>	<p align="center">Article 37 Basic Vocational Training</p>	<p align="center">Član 37 Osnovna stručna obuka</p>
<p>1. Të gjithë punëtorët e sigurimit duhet të përfundojnë trajnimin themelor profesional.</p> <p>2. Punëtori i sigurimit pajiset me certifikatën që dëshmon se ka përfunduar me sukses trajnimin themelor profesional të kërkuar.</p> <p>3. Të gjitha programet e trajnimit themelor profesional duhet të aprovohen nga Organi Kompetent.</p> <p>4. Punëtori i sigurimit që posedon certifikatën që dëshmon se me sukses ka përfunduar trajnimin themelor profesional, duhet të kalojë provimin e organizuar nga Organi Kompetent para se t'i lëshohet licenca që të veprojë si punëtorë themelor i sigurimit.</p> <p>5. Trajnimi themelor profesional përfshijë por nuk kufizohet në:</p> <p>5.1.Shërbimet e Sigurisë Private;</p> <p>5.2.Punëtorin e sigurimit;</p> <p>5.3.Pajisjet e sigurimit;</p> <p>5.4.Procedurat praktike të sigurimit;</p> <p>5.5.Procedurat emergjente;</p> <p>5.6.Përdorimin e forcës;</p>	<p>1. All Security Workers must complete Basic Vocational Training.</p> <p>2. A Security Worker shall be provided with a certification proving that they have successfully completed the required Basic Vocational Training.</p> <p>3. All Basic Vocational Training programs must be accredited by the Competent Body.</p> <p>4. A Security Worker holding a certificate stating that they have successfully completed Basic Vocational Training must pass an examination organized by the Competent Body prior to being granted a Licence to act as a Basic Security Worker.</p> <p>5. Basic Vocational Training will, cover the following items at a minimum:</p> <p>5.1. The private security services;</p> <p>5.2. The Security Worker;</p> <p>5.3. Security equipment;</p> <p>5.4. Practical security procedures;</p> <p>5.5. Emergency procedures;</p> <p>5.6. Use of force;</p>	<p>1. Svi radnici obezbeđenja treba završe osnovnu stručnu obuku.</p> <p>2. Radnik obezbeđenja će biti optremljen sertifikatom koji dokazuje da je završio sa uspehom zahtevanu osnovnu stručnu obuku;</p> <p>3. Svi programi osnovne stručne obuke treba da se akreditiraju od Nadležnog Organa;</p> <p>4. Radnik obezbeđenja koji poseduje sertifikat koji dokazuje da je sa uspeom završio osnovnu stručnu obuku, traba ta položi ispit organizovanog od Nadležnog Organa pre izdavanja licence za rad kao radnik osnovnog obezbeđenja;</p> <p>5. Osnovna stručna obuka minimum će obuhvatiti ali ne ogranicava se:</p> <p>5.1. uslugama privatne bezbednosti;</p> <p>5.2.Radnika obezbeđenja;</p> <p>5.3.Opremu obezbeđenja;</p> <p>5.4.Praktične postupke obezbeđenja;</p> <p>5.5.Emergentne postupke;</p> <p>5.6.Primenu sile;</p>

<p>5.7.Ligjin dhe punëtorin e sigurimit; 5.8.Parandalimin e zjarrit; 5.9.Shëndetin dhe sigurinë; 5.10.Ndihmën e parë; 5.11.Kujdesin për klientin dhe kualitetin; 5.12.Komunikimet; 5.13.Marrëdhëniet dhe rregullativa e punës; 5.14.Kriteret e vlerësimit të situatës; 5.15.Kodin e mirësjelljes.</p> <p>6. Trajnimi themelor profesional duhet të jetë në harmoni me doracakun e trajnimit të zhvilluar nga Konfederata Evropiane e Shërbimeve të Sigurisë (KEShS).</p> <p>7. Trajnimi themelor profesional, i kryer brenda ose jashtë vendit, më tej do të përcaktohet me akt nënligjor në përputhje me Standardet Profesionale të Kosovës.</p>	<p>5.7. Law and the Security Worker; 5.8. Fire prevention; 5.9. Health and safety; 5.10. First Aid; 5.11. Clients' care and quality; 5.12. Communications; 5.13. Labour relations and regulations; 5.14. Assessment criteria of the situation; 5.15. Code of conduct.</p> <p>6. Basic Vocational Training shall be in line with the training manual developed by the Confederation of European Security Services (COESS).</p> <p>7. Basic Vocational Training done within the country or abroad, shall be further described in Sublegal Act in accordance with the Kosovo Professional Standards.</p>	<p>5.7.Zakon i radnik obezbeđenja; 5.8.Sprečavanje požara; 5.9.Zdravlje i bezbednost; 5.10.Prva pomoć; 5.11. Briga o klientu i kvalitetu; 5.12. Komuniciranje; 5.13.Regulatorni odnosi rada; 5.14. Kriterijumi procene situacije; 5.15.„Kod“ dobrog ponašanja.</p> <p>6. Osnovna stručna obuka treba da bude u skladu sa priručnikom obuke izrađenog od Evropske Konfederacije Službi Bezbednosti (EKSB).</p> <p>7. Osnovna stručna obuka završena unutra ili van zemlje će se regulisati sa podzakonskim aktom u skladu sa Stručnim Standardima Kosova.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 38 Trajnimi specializuar</p>	<p style="text-align: center;">Article 38 Specialist Training</p>	<p style="text-align: center;">Clan 38 Specijalizovana obuka</p>
<p>1. Trajnimi specializuar zbatohet në pajtim me Standardet Profesionale të Kosovës për punëtorët e specializuar të sigurimit:</p> <p>1.1. Operatorët e mbrojtjes së afërt; 1.2. Rojet e TPG-së; 1.3. Mbajtësit e qenëve; 1.4. Operatori i Qendres së Kontrollit;</p>	<p>1. Specialist Training will be implemented in accordance with the Kosovo Professional Standards for the following Specialist Security Workers:</p> <p>1.1. Close Protection Operatives; 1.2. CIT Guards; 1.3. Dog-Handlers; 1.4. Control Center Operator;</p>	<p>1. Specijalna obuka će se primeniti u skladu sa Stručnim Standardima Kosova za sledeće radnike specijaliste obezbeđenja:</p> <p>1.1 Operativce bliske odbrane; 1.2 čuvare TGN-a; 1.3 Držaoce pasa; 1.4 Operator Kontrolnog Centra;</p>

<p>1.5. Menaxherët e sigurimit/Zyrtarët në detyrë.</p> <p>2. Përfundimi i trajnimit themelor profesional është kusht i domosdoshëm para fillimit të trajnimit të specializuar.</p> <p>3. Punëtori specializuar i sigurimit do të pajiset me certifikatën që dëshmon se e ka përfunduar me sukses trajnimin specializuar të kërkuar.</p> <p>4. Trajnimi specializuar kryhet vetëm nga institucionet e licensuara nga organi kompetent për ofrimin e programeve të trajnimit të specializuar.</p> <p>5. Të gjitha programet e trajnimit të specializuar duhet të aprovohen nga Organi Kompetent.</p> <p>6. Kompania Private e Sigurimit, mund të aplikojë për licensë që të bëhet institucion i trajnimit të specializuar, përveç operatorëve të mbrojtjes së afërt dhe rojeve e TPG-së, të cilët duhet të trajnohen për armë të zjarrit vetëm në përputhje me Ligjin për Armë.</p> <p>7. Punëtori i sigurimit që posedon certifikatën dhe dëshmon se me sukses ka përfunduar trajnimin e specializuar duhet të kalojë provimin e organizuar nga Organi</p>	<p>1.5. Security Managers/Duty Officers.</p> <p>2. Completion of Basic Vocational Training is a necessary requirement prior to commencing Specialist Training.</p> <p>3. A Specialist Security Worker shall be provided with a certification proving that they have successfully completed the required Specialist training.</p> <p>4. Specialist Training shall only be carried out by institutions licensed by the Competent Body to provide Specialist Training programs.</p> <p>5. All specialist training programs must be accredited by the Competent Body.</p> <p>6. A Private Security Company may apply for a Licence to become a specialist training institution, except for Close Protection Operatives and CIT Guards that must receive their firearms training in accordance with Law on weapons only.</p> <p>7. A Security Worker holding a certificate stating that they have successfully completed specialist training must pass an examination organized by the Competent</p>	<p>1.5 Rukovodiocë obezbeđenja /sluzbenik na dužnosti.</p> <p>2. Završenje osnovne stručne obuke je neophodan uslov pre početka specijalizacije obuke.</p> <p>3. Radnik specijalista obezbeđenja će biti opremljen sertifikatom koji dokazuje da je završio zahtevanu specijalnu obuku.</p> <p>4. Specijalna obuka će se vršiti samo od licenciranih institucija od Nadležnog organa za pružanje programa specijalizovano obuke.</p> <p>5. Svi programi specijalizovani obuke treba da budu odobreni od Nadležnog Organa.</p> <p>6. Privatne Kompanija Obezbeđenja može da aplicira za licencu za instituciju specijalne obuke, svakako, operativci bliske odbrane i čuvari TGN-a treba da se obučavaju za vatreno oružje samo u skladu sa Zkonom o Oruzju.</p> <p>7. Radnik obezbeđenja koji poseduje sretifikat koji dokazuje da je sa uspehom završio specijalnu obuku, treba da položi ispit organizovanog od Nadležnog Organa,</p>
---	---	---

